



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1047/1 Prot.

Tiranë, më 12/04 /2025

V E N D I M

Nr. 15, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
TEKNOLOGJITË E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT, ME NËNFUSHA
INXHINIERI INFORMATIKE DHE NËNFUSHA TELEKOMUNIKACION DHE
INXHINIERI INFORMACIONI, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 175, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Përdorimi i transistorëve me efekt fushe me nanotuba karboni si element sensor në fenomenet e fluideve në shkallë nano;
2. Ndërtimi i Sistemeve Kompjuterike me Inteligjencë Artificiale Bazuar në Trajtime me të Dhëna Lokale;
3. Përdorimi i mjeteve fluturuese pa pilot (dronëve), IoT dhe IA për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në Shqipëri.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, me nënfusha Inxhinieri Informatike dhe nënfusha Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni, të riorganizuar, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

